



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

RAPORTI VJETOR 2023

*Të jetojmë nga toka
dhe puna jonë!*



Mirënjohje për donatorët dhe partnerët

IADK falënderon të gjithë donatorët, komunat dhe partnerët e tjerë për ndihmën e vazhdueshme në arritjen e qëllimeve të përbashkëta “bujqësia sektor me prespektivë për punësim dhe gjenerim të të ardhurave” .

Brot
für die Welt

cfd
/ Stärkt Frauen.
Öffnet Perspektiven.



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Të gjitha të drejtat e rezervuara, IADK
Vushtrri, 2024



SOT, TA BËJMË MË MIRË BUJQËSINË TONË, QË TË KEMI NJË ARDHME TË SIGURTË PËR BREZAT E ARDHSHËM

Të nderuar lexues,

Si një nga organizatat joqeveritare të bujqësisë, ndër më të mëdha në vend, qëllimi i IADK-së është të zhvillojë sektorin e bujqësisë duke ofruar mbështetje për fermerët tanë të vlefshëm që përmes ngritjes së aftësive dhe ofrimit të granteve ne ndihmojmë në rritjen e ekonomisë, përmirësojmë rendimentin, uljen e kostove, rritjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë mjedisore, e mbi të gjitha krijojmë një mirëqenie për brezat e ditëve tona dhe ata që do të vijnë pas nesh.

Viti 2023 vlerësohet si një vit mjaftë sfidues, kjo përshkak të kushteve klimatike që kanë përcjellur një pjesë të vitit, kushte të cilat kanë bërë që bujqësia të ketë vështirësi e fermerët të kenë kufizime në prodhimet e tyre. Viti i lënë pas dhe kriza e vazhdueshme na kujtuan se është thelbësore të qëndrojmë të bashkuar drejt pabarazisë, varfërisë dhe mbrojtjes së burimeve tona natyrore. Ne besojmë fuqishëm që viti që do të vie

do të jetë vit i suksesve, vit ku fermerët tanë do të kenë mundësi të rrisin sipërfaqet e tyre do të jetë vit ku konsumatorët nuk do të kenë barrën e produkteve cilësore të prodhuar me shumë zellë e përkushtim nga fermat tona.

Së bashku me ju dhe falë ndihmës së pakursyer të donatorëve tanë, ne kemi arritur që të jemi afër të gjithë atyre që bujqësinë e shohin si një ndër hallkat kryesore të zhvillimit, prandaj në emër të organizatës më lejon që të shpreh mirnjohjen dhe falënderimin për këtë rrugëtim. Së bashku kemi arritur që të rrisim sipërfaqet me serra dhe dredhëz, kemi ndihmuar që të përmirësojmë cilësinë e të gjithë produkteve bujqësore, me theks në prodhimin e perimeve, dredhëzës dhe qumështit. Kemi arritur që të fuqizojmë sektorin e përpunimit të ushqimit përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe mbështetjes në hapjen e njësive të reja përpunuese e mbi të gjitha kemi ndihmuar në zvoglimin e ndotjes së tokës dhe lumenjëve që vije si rezultat i përdorimit të pakontrolluar të plehrave dhe pesticideve.

IADK vazhdon të fuqizohet në fushën e ofrimit të këshillave dhe trajnimeve praktike, sa kaq tani kemi filluar në ndërtimin e serrës dhe fushave tjera model dhe demonstruese në sipërfaqen prej 25 ari, parcelë e blerë nga IADK me fondet e donatorit BftW.

Ju lutemi, vazhdoni të lexoni këtë raport, në mënyrë që njiheni me punë tonë të përbashkët dhe me të arriturat në fuqizimin e bujqësisë.

Sinqerisht i juaji,

Zenel Bunjaku

Drejtor Ekzekutiv i IADK-së

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2005. Misioni ynë është promovimi i zhvillimit socio-ekonomik të zonave rurale, zvogëlimi i papunësisë dhe krijimi i mundësive për gjenerimin e të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.



PËRMBAJTJA

Fushëveprimi ynë	7
Puna jonë në numra	8
Donatorët, Projektet dhe Shërbimet.....	10
Sektori i Perimeve.....	11
Sektori i Pemëve	13
Sektori i Blegtorisë	16
Sektori i përpunimit të ushqimit	19
Përfshirja gjinore dhe komunitetit jo shumicë	21
Digjitalizimi në Bujqësi	22
Praktika dhe Punësimi për Student	23
Vizita studimore dhe panairët	25
Shërbimet e ofruara nga ne	26
Partneritetet ndërkombëtare.....	27
Të ardhurat e IADK-së nga Projektet/Grantet	28
Të ardhurat e IADK-së nga Projektet/Shërbimet	29
Mirënjohje për stafin	30



FUSHËVEPRIMI YNË

IADK ka punuar në 23 komuna të Kosovës duke ofruar mbështetje për fermerë, gra e burra, të rinjë e të reja nga këto komuna (në disa komuna me dy e më shumë projekte)

- | | | |
|-----------------------|------------------|--------------|
| 1. Leposaviq | 9. Obiliq | 17. Kamenicë |
| 2. Zveçan | 10. Fushë Kosovë | 18. Viti |
| 3. Zubin Potok | 11. Lipjan | 19. Ferizaj |
| 4. Mitrovica e Jugut | 12. Shtime | 20. Shtërpce |
| 5. Mitrovica e Veriut | 13. Prishtinë | 21. Kaçanik |
| 6. Vushtrri | 14. Podujevë | 22. Pejë |
| 7. Skënderaj | 15. Novobërdë | 23. Klinë |
| 8. Drenas | 16. Gjiilan | |

Më kryesoret në 2023:



338 përfitues, **32%** e tyre janë gra/vajza



752,252 Euro të ardhura vjetore nga grantet – projektet




104,891 Euro të adhura vjetore nga shërbimet



11 projekte dhe shërbime



24 punonjës dhe **6** praktikantë



PUNA JONË

338 Përfitues



109 Përfituese janë gra ose 32%
229 Përfitues janë burra ose 68%

119
 Përfitues janë të rinj (18-35 vj.) ose 35%



2 Pika grumbulluese të qumshtitë



91 Përfitues në sektorin e perimeve të mbështetur me serra (31) dhe pajisje mbështetëse (60)



1 Bletar është mbështetur me pajisje për bletari



1 Përfitues është mbështetur në sektorin e shpeztarisë



1 Biznes udhëhequr nga një grua



92 Përfitues Fermer janë mbështetur në sektorin e blegtorisë



1293 Këshilla direkte në terren



37 Trajnime për aftësi të buta, marketing dhe financa, 110 pjesëmarrës



120 Përfitues janë mbështetur në sektorin e pemëve

N Ë N U M R A



32
Praktikantë



12
Studentë
të punësuar



15
Vizita
studimore



1
Ditë fushore



84 Trajime
profesionale,
71 pjesëmarrës



56 Kandidatë
u certifikuan
pas përfundimit
të trajnimeve
profesionale

Publikimet:

1 Raport



1 Video promovuese



10 Përfitues
0 - 500€



11 Përfitues
501 - 1,000€



34 Përfitues
1,001 - 2,000€



8 Përfitues
2,001 - 3,000€



10 Përfitues
3,001 - 4,000€



1 Përfitues
4,001 - 5,000€



18 Përfitues
>5,000€

DONATORËT, PROJEKTET DHE SHËRBIMET

	 / Stärkt Frauen. Öffnet Perspektiven.	 USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE		 FAIRshare DIGITAL TOOLS FOR FARM ADVISORS	
Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës - Brot für die Welt	Fuqizimi i të rinjve dhe grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit – CFD	Rritja e zhvillimit të aftësive në sektorin e përpunimit të ushqimit në Kosovë – USAID Compete Activity	Forcimi i zinxhirit të vlerës përmes programit të zhvillimit të aftësive - GIZ	Digjitalizimi i shërbimeve këshillimore në fushën e bujqësisë – Fairshare	Shërbime profesionale të ofruara për Swiss Contact, EPI Centar, SKAT, DRC dhe Swiss Caritas

SEKTORI I PERIMEVE

Kosova vazhdon të ketë zhvillim pozitiv sa i përket kultivimit të perimeve, sipas të dhënave nga raporti i gjelbër 2023 llogariten gjithsej 19,571 ha sipërfaqe me perime të kultivuara në fushë të hapur, serra dhe kopshte, pra një rritje prej 0.9% në krahasim me vitin paraprak. Pavarësisht zhvillimeve dhe mundësive që ofron Kosova për fuqizimin e sektorit, prodhimtaria e perimeve, sidomos kultivimi në fushë të hapur është përballur me kushte të pafavorshme klimatike gjatë vitit 2023, të cilat kanë penguar përgatitjen cilësore të tokës, shtyrjen e afateve të mbjelljes dhe vështirësive në zbatimin e masave agroteknike.

Adresimi i këtyre shtatave dhe vështirësive që kanë prodhuesit kërkonë një përkushtim të të gjithë akterëve, prandaj një rolë të rëndësishëm ka luajtur edhe IADK duke përkrahur fermerët me serra dhe inpute përcjellëse, si masë për të mundësuar fermerëve që të prodhojnë prodhime cilësore dhe më pakë të ndikuar nga faktorët e jashtëm.

Mbështetja e fermerëve të vegjël, më saktësisht atyre që në ndonjë formë janë të larguar nga mundësitë financiare nga institucionet e tjera është synim i organizatës IADK, që përmes granteve të ofroj mundësi që fermerët e vegjël të fuqizohen dhe në të ardhmen të zgjerojnë biznesin e tyre në fushën e prodhimit të perimeve. Për këtë, gjatë vitit që kaluam, përmes fondeve të ndryshme nga donatorët besnik, ne kemi arritur të mbështesim 31 fermer (15 gra dhe 16 burra) me serra të sipërfaqeve nga 100 deri 176 m² përcjellur me inpute të nevojshme për kultivim të suksesshëm të perimeve. Krahas serrave, IADK ka arritur të mbështes edhe 60 fermerë të tjerë me pajisje esenciale për kultivuesit e perimeve në serra dhe fushë të hapur. Për fermerët e vegjël, potencialisht me njohuri të vogla sa i përket kultivimit dhe praktikave të mira bujqësore, do të ishte e parëndësishme përkrahja me grante nëse nuk do të kombinohej me ofrimin e këshillave direkte. Prandaj, ekspertët e fushës në mënyrë të vazhdueshme kanë ofruar trajnime praktika në kultivimin dhe zbatimin e praktikave moderne për prodhim cilësorë të perimeve. Falë kësaj mbështetje, ne sot kemi afër 0.50 ha më shumë sipërfaqe të kultivuar me perime, njëkohësisht prodhime cilësore të vendit.

Ndonëse ishte vit i vështirë në rritjen e prodhimit dhe cilësisë, sidoqoftë konsiderohet i suksesshëm në plasimin e prodhimit dhe çmimeve të larta të shitjes. Kjo është parë nga të hyrat mesatare të 20 përftuesve të serrave me sipërfaqe nga 176 m², të cilët nga kultivimi i specave dhe domateve në këto serra kanë krijuar të ardhura nga 1,500Euro, të cilat do të ngritën edhe më tej nga kultivimi i perimeve në sezonin vjeshtor.





Ofrimi i trajnimeve, këshillave direkte dhe monitorimi i afërtë i fermerëve, do të mundësoj që fermerët të rrisin njohuritë profesionale për teknikat e kultivimit të perimeve dhe organizimin sa më të mirë të punëve për shfrytëzim racional të serrave dhe gjenerimin e të ardhurave nga kjo veprimtari.

Sot ne ndajm një storie të suksesit nga përftuesi Z. Shemsi Babatinca nga komuna e Podujevës, i cili është një nga 20 përftuesit e serrës prej 176 m², fidaneve dhe inputeve tjera përcjellëse. Ai është marrë me prodhimin e perimeve edhe më parë, duke kultivuar ato në fushë të hapur në sipërfaqe prej 1.5 ha, por përshkakë të kushteve klimatike dhe mundësive që ofron kultivimi i perimeve në serra ai ka pasur një interesim të jashtëzakonshëm që të vazhdoj prodhimin e perimeve në serra. Me një familje prej katër anëtarëve dhe me një burim të të ardhurave vetëm bujqësinë, Babatinca ka hulumtuar mundësitë e financimit, me qëllim që të rris cilësinë e prodhimit dhe njëkohësisht të prodhoj perime edhe në sezonën vjeshtore.

Duke parë vullnetin dhe gatishmërinë që të thelloj aktivitetin e tij në prodhimin e perimeve, IADK përmes projektit ka mbështetur atë me serrë, inpute dhe këshilla. Shfrytëzimi racional i të mirave të ofruara nga IADK i ka mundësuar Z. Babatinca që në serrë të prodhoj 2100 kg specja dhe domate cilësore me një qmim prej 2,200 euro të hyra për familjen. Kjo ishte vetëm një pjesë, pasi fermeri nuk u ndal me kaq, ai përdori serrën edhe gjatë sezonës së vjeshtës duke mbjell spinaq dhe duke shitur atë në tregun vendor, krahas duke rritur të ardhurat familjare edhe për 300 euro.

“Mbështetja me serrë dhe inpute përcjellëse fillimisht më ka ndihmuar që të rris të ardhurat familjare, njëkohësisht më ka shtyrë që të hulumtoj mundësi financiare shtesë për zgjerim të sipërfaqeve me serrë, përfundon storien Z. Babatinca”

91
fermerë të
mbështetur

449
këshilla direkte
për 91 fermerë

4 sesione
të trajnimeve
teorike

14470 mij
fidane të
shpërndar
për fermerët

5
vizita studimore
për përftuesit
e sektorit

SEKTORI I PEMËVE

Kosova ofron kushte optimale për zhvillimin e pemtarisë, në veçanti kultivimin kualitativë të mollës, mjedrës, dredhëzë, arrës ejt. Këto, dhe shumë kultura të tjera konsiderohen me prioritet dhe potencial të lartë për krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e të ardhurave. Me një sipërfaqe prej 10,619 ha me pemë, Kosova tregon se ofron një mundësi të artë të zhvillimit të suksesshëm të pemtarisë. Kulturat të cilat zënë sipërfaqen më të mëdha janë molla me 3,091 ha, kumbulla 2,214 ha, mjedra 1,668 ha, arra 1,540 ha, pasuar nga dardha, lajthia, dredhëza, vishnja, etj të cilat kanë sipërfaqe nën 1,000 ha.

Pamvarësishtë potencialit dhe rritjes së vazhdueshme, tregu i Kosovës tradicionalisht është mbështetur në import të frutave për të përmbushur kërkesën e brendshme. Rendimenti i ulët, i lidhur me praktikat e përdorur dhe mungesën e hapsirave të ruajtjes afatgjatë, kontribuon në import të frutave.

Megjithatë, tendencat e fundit tregojnë një zhvillim të shpejtë në sektorin e frutave, me përmirësim të kapaciteteve prodhuese, rendimenteve dhe investime të konsiderueshme në hapsirat ruajtëse e përpunuese. Këto zhvillime pozitive synojnë të reduktojnë varësinë nga frutat e importuara dhe të nxisin rritjen e prodhimit vendas të frutave.

Një rolë pozitive në këtë qëllim, luajnë padyshim institucionet publike dhe ato lokale e ndërkombëtare që përmes programeve synojnë të fuqizojnë dhe avansojnë sektorin. Në këtë drejtim, rol thelbësorë ka edhe organizata IADK që përmes programeve të këshilldhënjes, ditëve fushore, panaireve dhe granteve mundësonë që fermerët të prodhojnë produkte cilësore, të gjenerojnë të ardhurave dhe njëkohësisht të zvogëlojnë efektin negativë në ambiente që potencialisht mund të vie nga bujqësia.

Një vitë i suksesshëm ishte për prodhuesit e dredhëzës, ku IADK përmes projektit të financuar nga BftW, ka mbështetur 10 përfitues (3 gra/vajza dhe 7 burra) nga komuna e Suharekës kanë arritur të shtojnë sipërfaqen totale me dredhëz për 1.5 hektarë duke mbjellur dy kultivar (Alba dhe Albion) të kërkuar në tregun e Kosovës. Përpos fidaneve cilësore (klasa A+) dhe me qëllim të krijimit të një ambienti të përshtatshëm për kultivim, fermerët janë mbështetur edhe me sistem të ujitjes dhe foli plastike për mulqirim. Mbështetja me grant pa trajnime dhe vizita do të ishte e pa vlerë, prandaj ekspertët e IADK-së në mënyrë të vazhdueshme kanë qenë afër fermerëve në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale përmes këshillave direkte dhe vizitave studimore.





Molla dhe mjedra janë dy nga kulturat që përbëjnë 45% të të gjithë sipërfaqes së mbjellur me pemë, por pavarësisht shtrirjes dhe zgjerimit, menaxhimi i suksesshëm i tyre, rritja e prodhimit, përmirësimi i cilësisë dhe zvoglimi i ndotjes që vënie nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave, pesticideve dhe ujitjes, kërkon përdorimin e praktikave bashkëkohore. Në këtë drejtim, IADK në bashkëpunim me partnerin e saj EPI Centar dhe financuar nga SKAT ka arritur të mbështes me këshilla dhe grante 50 fermerë, kultivues të mollës (33) dhe mjedrës (17). Një nga këta përfituesit është edhe Z. Fehim Ibishi, fermer i mjedrës nga Podujeva, i cili dëshmon për ndikimin pozitiv të shfrytëzimit të të dhënave nga stacioni uMethos (stacion i matjes së lagështisë së tokës dhe temperaturës përmes sensorëve). Përdorimi i të dhënave të ofruara nga ky stacion ka kontribuar ndjeshëm në reduktimin e përdorimit të ujit, duke mundësuar ujitje më të saktë dhe efikase të përshtatur për nevojat specifike të bimëve. Gjithashtu, mbështetja me pajisje të tjera bujqësore jo vetëm që kanë mundësuar rritjen e sipërfaqes së kulturave bujqësore, por kanë sjellë edhe uljen e kostove të prodhimit dhe lehtësimin e punëve në bujqësi.

Në përdorimin e plehrave, historikisht, fermerët janë mbështetur në përvojën e tyre personale dhe informacionin e dhënë nga shitësitë. Sasi të mëdha të plehrave përdoren një ose dy herë në vit pa analiza paraprake laboratorike të tokës ose vlerësim të lëndëve ushqyese të disponueshme. Duke pranuar se metodat e tyre aktuale mund të mos jenë optimale, 50 fermerët shprehin interes për të zgjeruar njohuritë e tyre mbi përdorimin e duhur të plehrave. Ndryshimet globale kanë rritur koston e plehrave dhe kanë bërë të papërballuar për shumë fermerë. Fermerët iu nënshtruan trajnimeve për të adoptuar metodat më të mira dhe për të përdorur mjetet optimale, me fokus në minimizimin e përdorimit të panevojshëm të plehrave. Trajnimi ofroi konceptin e përdorimit racional të plehrave, duke inkurajuar fermerët të zbatojnë masa më të kontrolluara dhe më të sakta. Ky ndryshim drejt praktikave të kontrolluara jo vetëm që siguron shfrytëzim efikas të burimeve, por gjithashtu përputhet me parimet e qëndrueshme bujqësore, duke promovuar mjedisin dhe duke rritur efektivitetin e përgjithshëm të përdorimit të plehrave.





Kombinimi strategjik dhe ofrimi i trajnimve dhe investimeve ka lehtësuar zbatimin e sistemit të ujitjes pik-pik për përdorimin racional të plehrave, prandaj kjo qasje inovative ka siguruar që plehrat të përdoren në sasi sipas nevojave specifike të bimës. Për të rritur efikasitetin e përdorimit të sasive dhe llojeve të përshtatshme të plehrave për nevojat specifike të bimëve, përveç mbështetjes nëpërmjet granteve dhe trajnimeve, 50 fermerë kanë përfituar nga analizat laboratorike të mostrave të dheut për parcelat e caktuara. Duke përdorur rezultatet e analizave laboratorike, stafi i projektit ka formuluar një program të detajuar për plehërimin e kulturave për secilën fermë, prandaj bazuar në këto të dhëna, fermerët u udhëzuan për përdorimin e plehrave, duke përfshirë llojin e plehut, sasitë e rekomanduara dhe kohën optimale për aplikim.

Një storie e këtij suksesi është edhe Znj Rezarta Menxhiqit e cila ka vërejt efektin pozitiv të adoptimit të praktikave të rekomanduara përdorimit të plehrave. Duke iu përmbajtur rekomandimeve të dhëna, sasia e prodhimit të mjedrës gati u dyfishua në krahasim me vitin paraprak. Veçanërisht, ky vit shënoi një moment historik të rëndësishëm pasi Rezarta filloi të përdorë plehrat foliar bazuar në rekomandimet

për herë të parë. Përvoja e saj nënvizon përfitimet e prekshme të zbatimit të strategjive të informuara dhe të përshtatura të plehrave, duke rezultuar në një rritje të konsiderueshme në rendimentin.

Arra përfaqësonë rreth 15% të të gjithë sipërfaqes me pemë dhe në këto vitet e fundit është një nga kulturat me interesimin më të madh nga fermerët si në aspektin e zgjerimit të sipërfaqeve, përmirësimit të cilësisë dhe promovimit të saj në nivel të Kosovës. Në zhvillim të këtij sektori luajnë rolë shumë akterë të ndryshëm dhe padyshim IADK edhe gjatë këtij viti ka ofruar mbështetje në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale për fermerët, e mbi të gjitha organizimin e ditës së arrës në nivel të Kosovës. Në bashkëpunim me shoqatën e arrës dhe lajthisë së Kosovës dhe Pnancuar nga GLZ, në fshatin Gjinoc në komunën e Suharekës është mbajtur dita tradicionale e arrës me pjesmarrjen e mbi 130 fermerëve, përfaqësues të organizatave të ndryshme, donator dhe përfaqësues të komunave.



120
fermerë
të
mbështetu



396
këshilla
direkte



9 sesione
të trajnimit
teorikë për
fermerët e
mbështetur



5
vizita
studimore



1
ditë fushore
"dita e arrës"
me 130
pjesmarrës



SEKTORI I BLEGTORISË

Blegtoria paraqet një sektor të rëndësishëm në bujqësi, me një ndikim të theksuar në zhvillimin ekonomik, sigurinë ushqimore dhe kontributin në mirëqenien e përgjithshme të popullsisë në Kosovë. Potenciali i lartë i këtij sektori vjen nga përdorimi i një sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore për kullotje dhe prodhimin e ushqimeve të nevojshme për bagëti. Sipas të dhënave nga Raporti i Gjelbër, të vitit 2023, Kosova ka një pasuri të tokës bujqësore, nga totali i sipërfaqes të shfrytëzuar të tokës bujqësore, pjesa më e madhe e saj, ose 51.6% (216,998 ha) është sipërfaqe me kullota dhe livadhe. Po nga i njëjti burim, gjedhet janë kategoria më e rëndësishme duke përbërë 47.2%, të lopëve qumështore me rreth 130,493 krerë dhe me prodhimatari vjetore të qumështit rreth 276 mijë tonë.



Megjithëse ka kushte të favorshme tokësore dhe një klimë të përshtatshme, sektori i blegtorisë në Kosovë ka përjetuar sfida të reja në vitet e fundit, të dhënat tregojnë se ka një ulje prej 1% të sasisë së prodhimit të qumështit dhe 1.2% ose 1,583 krerë më pakë të lopëve qumështore krahasuar me vitin paraprak. Ndryshimet klimatike, rendimentet e ulëta të kulturave bujqësore, rritja e kostove për përgatitjen dhe blerjen e ushqimeve për fermë, si dhe cilësia jo adekuatë e ushqimeve kanë ndikuar si në prodhimtarin e qumështit ashtu dhe atë të mishit.

Për adresimin e këtyre sfidave luajnë rolë një numër i madh i organizatave, padyshim edhe IADK përmes mbështetjes dhe avancimit të sektorit të blegtorisë, më saktësishtë ofrimin e granteve, shërbimeve këshilluese, vizitave studimore dhe trajnimeve të ofruara sipas programit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP) "Teknik i Blegtorisë" niveli III, të KKK ka bërë që të zhvilloj edhe fuqizojë sektorin e blegtorisë.

Për përgatitjen e kandidatëve sipas kërkesave të sektorit dhe tregut, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka bërë riakreditimin e IADK-së njëkohësisht ka rivaliduar programin e trajnimeve profesionale në sektorin e blegtorisë. Tani, kandidatët duke ndjekur këto trajnime do të kenë mundësi të pajisem me certifikata të njohura në nivel vendi dhe më gjerë. Trajnimet e ofruara nga IADK janë fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese, përmirësimin e racave, cilësisë dhe sasisë së qumështit dhe mishit, si dhe përdorimin e teknikave të kultivimit dhe prodhimit të ushqimeve cilësore dhe të balancuara. Këto përpjekje synojnë të ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së kafshëve, cilësinë dhe sasinë e produkteve vendore, si dhe në promovimin e praktikave më të qëndrueshme bujqësore.



Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit është vështirë i arritshëm pa mbështetjen financiare të ofruar nga donatorët, një ndërë më kryesorët është edhe BfdW (Brot für die Welt) nga Gjermania që ka bërë të mundshëm mbështetjen me grante për 18 blegtorë, më saktësisht 14 përfitues nga komuna e Drenasit dhe katër (4) përfitues nga komuna e Podujevës. Përfshijra e grave në të gjithë sektorët e bujqësisë, përfshirë edhe blegtorinë në këtë rastë është synim i IADK-së, prandaj nga totali i përfituesve, ne kemi arritur të përzgjedhim dhe ofrojmë mbështetje për tre (3) gra të suksesshme në sektorin e blegtorisë. Përzgjedhja e paketës mbështetëse është bërë në përputhje me gjendjen e sektorit, kërkesat e fermerit dhe qëllimet e projektit, prandaj për të rritur kapacitet ruajtëse, përfituesit janë mbështetur me laktofrizë të kapaciteteve 300 L dhe/ose 500 L, për të përmirësuar cilësinë dhe rritur higjienën e qumështit, përfituesit janë mbështetur me makina mjelëse me dy tufa mjelëse dhe bidona të qumështit 20 L.



Një nga përfitueset e këtij viti është edhe zonja **Elfete Morina** nga fshati Dobroshec, Komuna e Drenasit, e cila posedon 18 gjedhe, prej të cilave 10 lopë qumështore. Si një grua, e cila jeton në zonat rurale dhe me kushte jo të mira për mbarëshkrimin e lopëve qumështore në një fermë të improvizuar, tregon se ka pasur shumë vështërsi në ruatjen dhe përmirësimin e cilësisë së qumështit “**më është dashur në shumë raste të hudhë qumështin sepse është prishur nga temperaturat e larta gjatë verës, ose është ngrirë shumë për shkak të ruajtjes në frizë sepse nuk kam pasur një pajisje të veçantë për ruajtje**”. Ajo thotë se qumështin, të cilin nuk e konsumoj për familjen time, nuk e dërgoj as tek pika grumbulluese e as tek konsumatorët. Elfetja, e lumtur tregon se nga mbështetja e IADK-së me laktofrizë 500L dhe dy bidona të qumështit dhe këshillat e marra ka arritur të përmirësoj cilësinë e qumështit, të subvecionohet për cilësi të qumështit dhe kështu të krijoj të ardhura më të larta nga ferma e saj. Tani, nuk kam brengën se a do të prishet qumështi për shkak të temperaturave të ulëta apo të larta, më nuk do të hudhë qumështë, prandaj do të jem shumë më konkurese në treg.



94
përfitues të
blegtorisë



2 pika
grumbulluese
të qumshtit



443
këshilla direkte



6
trajnime
profesionale



2
vizita studimore





Pas përfundimit me sukses të trajnimit, ajo është mbështetur me grantë nga IADK përmes projektit të financuar nga donatori Brot für die Welt (BftW), dhe sot ajo ka biznesin në pronësi dhe e menaxhon mjaftë suksesshëm. Shija dhe dekorimi i veçantë i ëmbëlsirave bëjnë Dea's Cakes një pikëndalesë të preferuar për porosi të llojeve të ndryshme të ëmbëlsirave për ahengje dhe ngjarje familjare, prandaj ajo ka propozinë **“Jeto ëmbël me ëmbëlsirat tona”**.

Krahas bërjes së ëmbëlsirave, sektori i agropërpunimit, më saktësishtë përpunimi i frutave dhe perimeve, vazhdonë të jetë sektor me potencial për përfshirjen e grave në punësim. Zonja Nadire Hasani nga fshati Frashër i Komunës së Mitrovicës ka treguar performancë të jashtëzakonshme në agropërpunim, me theks të veçantë në grumbullimin dhe përpunimin e frutave dhe perimeve, prandaj ajo është mbështetur me ndërtimin e një dhome ftohëse e cila do të shërbej për ruajtjen e lëndës së parë njëkohësishtë edhe për ato të përpunuara. Falë mbështetjes së ofruar dhe krahasuar me vitin e kaluar, kapaciteti prodhues/përpunues është rritur për 2000 kavanoza, përfshirë 5 ton spec, 600 kg kumbulla dhe 6 ton domate të gjelbërta, krahas rritjes së prodhimit zonja ka rritur edhe sasinë e eksportit për vitin 2023, e i cili ka qenë 70 ton. Suksesi i përfitueses në fjalë është shembull i ndikimit të IADK-së në sigurimin e produkteve ushqimore dhe rritjen e eksportit.

SEKTORI I PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

Përpunimi i ushqimit është duke shënuar progres të konsiderueshëm, duke kontribuar në rritjen e Bruto Prodhimit Vendor (BPV), rritjen e nivelit të punësimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore. Sektori i përpunimit vlerësohet të jetë një sektor me potencial për përfshirjen e grave si në aspektin ekonomik dhe social, pasi ofron mundësi punësimi dhe gjenerimi të të ardhurave.

Gratë, një nga grupet kryesore të synuara të IADK-së, vazhdojnë të kenë një shkallë të lartë të papunësisë, në veçanti gratë në zonat rurale. Të dhënat tregojnë se vetëm rreth 20% e grave në Kosovë janë të punësuar, dhe për 50% të grave niveli më i lartë i shkollimit është niveli fillor dhe kjo kryesisht, për shkak obligimeve familjare dhe paragjykimeve. Prandaj, mundësitë e limituara të punësimit, mungesat financiare dhe edukimi adekuat bëjnë këtë target grup më pak të përfshirë si në aspektin ekonomik dhe atë social. Në këtë aspekt, IADK ka ndërmarrë nisma për të fuqizuar fermerët e vegjël dhe gratë rurale, përmes përkrahjes me grante për ngritjen e fermave, pëmishteve dhe njësive të përpunimit.

Vlora Mexhuani, një nga shumë përfituesit e IADK-së, me një pasion të veçantë për përgatitjen e ëmbëlsirave, është zgjedhur si pëfituese e grantit për krijimin e biznesit të saj "Dea's Cakes". Edhe pse me profesion ekonomiste, Vlora gjithmonë është angazhuar në ushtrimin e pasionit të saj për ëmbëlsira. Vlora, ka ndjekur një cikël të arsimit dhe aftësimit profesional, përmes programit të akredituar "bërës ëmbëlsirash" në nivelin III, i cili është i validuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).

Nga ferma në tryezë, përpjekjet tona fokusohen në krijimin e një sistemi ushqimor më të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm në Kosovë, prandaj ne synojmë që përmes trajnimeve cilësore dhe mbështetjes me grante dhe pajisje të fuqizojmë sektorin në të mirë të komunitetit. Duke pasur parasysh, nevojën për ngritjen e ekspertizës profesionale në sektorin e përpunimit të ushqimit, IADK ka angazhuar ekspertë nga Holanda për trajnimin e punëkërkuarëve dhe punonjëseve në sigurinë ushqimore, cilësinë, teknologjinë e ruajtjes, dhe zhvillimin e produkteve.

Në vitin 2023, IADK ka mbajtur trajnime për 71 kandidatë, prej të cilëve 56 janë certifikuar me certifikatë valide ndërkombëtare të AKK-së:


 **15 gra u trajnuan
në ëmbëlsira
(të gjitha u certifikuan)**

 **15 gra përfunduan trajnimin
për konzervimin e pemëve, perimeve
dhe të ngjashme (10 u certifikuan)**

 **15 gra përfunduan trajnimin në
përpunimin e qumështit
(9 u certifikuan)**

**Nga 45 vajza/gra të trajnuara, të gjitha janë mbështetur me pajisje
esenciale në përpunimin e ushqimit**

**26 kandidatët
(11 punonjës, 15 punëkërkuarës),**



**22 u certifikuan
(12 vajza/gra, 10 djem/burra)**



PËRFSHIRJA GJINORE DHE KOMUNITETIT JO SHUMICË

Strategjia e IADK-së, ndër të tjera, është e përqëndruar në përfshirjen dhe aftësimin e grave dhe vajzave të reja. Me implementimin e aktiviteteve të projekteve, sidomos atyre të financuara nga donatori "CFD", janë mbështetur iniciativat e grave dhe vajzave të reja përmes përkrahjes me grante, këshilla direkte, vizita studimore dhe trajnime. Këto ndërhyrje kanë ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe fuqizimin e grave dhe vajzave të reja, si dhe kanë krijuar mundësi për të zhvilluar një përgjegjshmëri sociale dhe ekonomike.

Në shumicën e ngjarjeve dhe aktiviteteve relevante, pjesëmarrëse ishin gra dhe vajza nga GIGVA (Grupi Informal i Grave dhe Vajzave Aktive), themeluar me vetëiniciativë dhe përkrahur nga IADK.

1. Trajnim për Biznes dhe Plane të Biznesit:

- 50 gra nga grupi GIGVA janë trajnuar në IADK për krijimin e planeve të biznesit.

2. Ekspozitë e Veshjeve Tradicionale:

- Organizimi i një ekspozite me 12 pjesëmarrëse nga grupi i lartpërmendur për festimin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

3. Trajnime për Menaxhim Biznesi nga FINCA:

- Rreth 50 gra përptuan nga trajnimi për menaxhim biznesi dhe sipërmarrje nga FINCA, duke marrë certifikata pjesëmarrjeje.


4. Sensibilizim për Kancerin e Gjirit dhe Mamografi:

- Rreth 45 gra morrën pjesë në ligjeratë sensibilizuese për kancerin e gjirit nga QKMF-ja në bashkëpunim me IADK, nga ku 9 nga ato kanë realizuar mamografinë.

5. Tryezë Rrumbullakëte për Fuqizimin e Grave Rurale:

- Mbajtja e një tryeze me 22 pjesëmarrëse në IADK me temën "Fuqizimi i grave dhe të rinjve nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit".





Farmer registry 48 Farmers @ 395.66 ha

Search company: Country: City: Crops: Responsible people: [RESET FILTER](#) [Confirm](#)


Title	Country	City	Account status	Status end date	Fields	Crops	Actions
☐ Adem Begri	Kosovo	Skenderaj	Membership activated	11/25/2023	3.02 ha	1 Fields	
☐ Agim Rexhepi	Kosovo	Ishtog	Membership activated	11/25/2023	5.5 ha	2 Fields	
☐ Arifet Rrahmi	Kosovo	Podujevë	Membership activated	11/25/2023	2.5 ha	5 Fields	
☐ Bajram Kadriu	Kosovo	Skenderaj	Membership activated	11/25/2023	2 ha	1 Fields	
☐ Berat Muesliu	Kosovo	Podujevë	Membership activated	11/25/2023	0.7 ha	1 Fields	
☐ Besnik Berisha	Kosovo	Podujevë	Membership activated	11/25/2023	4.5 ha	4 Fields	
☐ Bujar Berisha	Kosovo	Ishtog	Membership activated	11/25/2023	5.62 ha	1 Fields	
☐ Bujar Bytyr	Kosovo	Ferizaj	Membership activated	11/25/2023	12.7 ha	1 Fields	
☐ Bujar Rexhepi	Kosovo	Ishtog	Membership activated	11/25/2023	4.4 ha	3 Fields	
☐ Daut Kociri	Kosovo	Vushtri	Membership activated	11/25/2023	1.34 ha	4 Fields	
☐ Dritan Metani	Kosovo	Ishtog	Membership activated	11/25/2023	3 ha	1 Fields	
☐ Eljan Haxhi	Kosovo	Mitrovicë	Membership activated	11/25/2023	0.5 ha	1 Fields	
☐ Fehriut Matoshi	Kosovo	Podujevë	Membership activated	11/25/2023	1 ha	2 Fields	
☐ Fikri Ajditi	Kosovo	Kamenica	Membership activated	11/25/2023	1.27 ha	1 Fields	
☐ Fikri Adem	Kosovo	Skenderaj	Membership activated	11/25/2023	3.1 ha	4 Fields	

DIGJITALIZIMI NË BUJQËSI

Dixhitalizimi në bujqësi i referohet integritet dhe adoptimit të teknologjive dixhitale për të përmirësuar aspekte të ndryshme të praktikave bujqësore, menaxhimit dhe proceseve të vendimmarrjes. Një bujqësi plotësisht dixhitale është një kombinim i fuqishëm i njerëzve, teknologjisë dhe aftësive organizative që i përshtatet në mënyrë ideale kontekstit të sotëm ekonomik dhe social.

Qasja e kufizuar midis prodhuesve, veçanërisht fermerëve të vegjël dhe qendrave të grumbullimit, në njohuri për teknikat e prodhimit, planifikimin e investimeve dhe rrjedhën e informacionit janë shkaqet më të theksuara që kufizojnë zhvillimin e bujqësisë. Ofrimi i njohurive teknike e profesionale dhe lidhja e fermerëve me këshilltarët nëpërmjet një platforme në internet si AGRIVI Farm Management Software do të mundësonte bujqësinë tonë të lulëzojë më shpejt duke qenë në konkurrence me trendet globale. Agrivi është një platformë në internet për gjurmimin e të gjitha operacioneve të fermave, të korrave dhe burimeve të tilla si personeli, makineritë, fushat dhe inventari i fermës, një platforme e cila është formuluar dhe përgatitur nga IADK në bashkëpunim me AGRIVI.

Kjo platformë ka mundësuar që të gjithë ekspertët tanë të kenë një lidhshmëri me 40 fermerë (nga e gjithë Kosova) në sektorin e pemëve dhe perimeve, duke mundësuar digjitalizimin e mbi 200 ha sipërfaqe të kultivuarë me kulturat kryesore si mollë, mjedër, kumbull, domate, spec, trangull etj. Me një sërë veçorish, kjo platformë ka ofruar një menaxhim të përshtatshëm të vjeljeve, planifikim racional të gjithë sezonës prodhuese, gjurmim të aspekteve fitosanitare të bimëve duke mundësuar zbulim të hershëm të dëmtuesve dhe sëmundjeve, pra kjo platformë ka ndihmuar fermerët dhe ekspertët me përgatitjen e tokës, ushqimin (llogaritjen), përdorimin e inputeve (organike dhe joorganike), distancën e mbjelljes për kulturat kryesore, etj. Platforma dixhitale ka shërbyer jo vetëm si një mjet këshillues, por edhe si një proces monitorimi dhe mësimi, kështu, duke njohur shkaqet dhe problemet, mund të adresojmë veprime efektive për të ardhmen e sezonit bujqësor. Në të ardhmen e afërt, platforma do të evoluojë në një platformë me bazë komerciale për shërbimet dixhitale bujqësore, duke vepruar si një model për shpërndarjen e njohurive për fermerët tanë në kohë dhe në mënyrë të dobishme.



PRAKTIKA DHE PUNËSIMI PËR STUDENT

Vendi ynë ka popullsinë më të lartë të të rinjve në të gjithë Evropën, duke përfaqësuar mundësi për një fuqi punëtore të lartë dhe të kualifikuar. Megjithatë, shkalla e lartë e papunësisë, sidomos te grupmosha 15-24 vjeçare, mbetet një çështje e rëndësishme, duke reflektuar mungesën e harmonizimit mes aftësive të fituara gjatë studimeve dhe kërkesave të tregut të punës. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në tre-mujorin e fundit të vitit 2022, shkalla e papunësisë tek të rinjtë ishte 19%, duke shënuar ulje (-15,6%) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në këtë grup, rreth 33.7% e të rinjve nuk janë në arsim, punë, apo trajnim, me një përqindje më të lartë për kategori të veçanta si gratë e reja, të rinjtë nga komunitetet e marginalizuara, dhe ata me aftësi të kufizuara. Tejkalmimi i hendekut arsim-punësim është thelbësor për zhvillimin profesional të të rinjve dhe çasjen në tregun e punës. Në këtë kontekst, IADK vazhdon përkrahjen e të rinjve të diplomuar në bujqësi dhe teknologji ushqimore, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë përvoja profesionale nëpërmjet programeve të punës praktike.



Në vitin 2023, IADK ka ofruar mbështetje për 32 të rinj, të diplomuar apo në përfundim të studimeve, nga shkencat bujqësore dhe teknologji ushqimore.

Të rinjtë janë përfshirë në trajnime për shkathtësi të buta, duke ndikuar pozitivisht në gatishmërinë e tyre për t'u përshtatur me kërkesat e tregut të punës.

Përmes këtij programi të punës praktike, përveç arritjes së përvojave të reja profesionale, është realizuar suksesshëm integrimi i 10 prej tyre në tregun e punës, duke kaluar nga pozita e "praktikantit" në atë të "punësuarit" në kompani të specializuara në bujqësi dhe agropërpunim.





Teuta Shkodra, e cila sapo ka mbaruar studimet në Bachelor për Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, është një nga të rinjtë që ka përfituar nga programi i praktikës i mbështetur nga IADK. Pas diplomimit, ajo hasi sfida në vazhdimin e karrierës së saj profesionale, duke e vlerësuar mungesën e eksperiencës profesionale si pengesë. Teuta, përfundoj praktikën tre-mujore në kompaninë Fluidi Corporation, ku falë përkushtimit dhe performancës së lartë, arriti të nënshkruajë një kontratë pune si punëtore e rregullt në këtë kompani. Teuta Shkodra, shprehet se kjo përvojë ishte e jashtëzakonshme dhe shumë e dobishme për zhvillimin e saj profesional, duke fituar njohuri të thella në procesin teknologjik të prodhimit të vajit të gatimit dhe analizave laboratorike. Ky përfitim i arritur nga praktika i ka hapur rrugën për një karrierë të suksesshme. Teuta Shkodra shpreh kënaqësinë dhe mirënjohjen për mbështetjen e IADK dhe kompanisë Fluidi Corporation. “Si rezultat i praktikës sime, jam në hapat e parë drejt zhvillimit të ekspertizës në procesin teknologjik të prodhimit të vajit për gatim. Ëndrra ime është realizuar dhe kjo falë mbështetjes së IADK-së dhe kompanisë Fluidi. Gëzohem që tani kam një pozicion pune dhe kam mundësinë të kontribuoj me të ardhura për veten time dhe familjen time”, përfundon Teuta Shkodra.



32
studentë
të angazhuar
në praktikë




29
prej tyre
gra/vajza



3
prej tyre
burra/djem



12
studentë
janë punësuar



38% shkalla
e suksesit
në punësim





14
Vizita studimore
të organizuara për
fermerët e sektorëve



5 Vizita në
Sektorin
e frutave



6 Vizita në
Sektorin
e perimeve



1 Vizita në
Sektorin
e përpunimit



2 Vizita në
Sektorin
e blegtorisë



182
Pjesëmarrës



74 ose 41%
ishin gra/vajza



108 ose 59%
ishin burra/djem



1
Vizit ndërkombëtare
me stafin e organizatës



VIZITA STUDIMORE DHE PANAIRET

Përmes vizitave studimore, ne ofrojmë mundësi që fermerët tanë të identifikojnë mundësitë për zhvillim ekonomik në zonat rurale, kjo përfshin dhe zhvillimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe mundësive për diversifikim të ekonomisë lokale. Nëpërmjet vizitave studimore, ne kemi bërë përpjekje që fermerët të njihen me teknologjitë e reja dhe të avancuara në bujqësi. Mbi të gjitha, vizitat studimore kanë ofruar një platformë për shkëmbimin e dijeve dhe përvojave në fushën e bujqësisë, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve lokale dhe në zhvillimin e njohurive.

IADK gjatë këtij viti ka ndihmuar fermerët që të promovojnë produktet e tyre përmes organizimit të panairove të ndryshme të cilat janë organizuar në nivel komunal në disa komuna. Këto panaire kanë ndihmuar fermerët që fillimisht të prezantojnë produktet e tyre, të shesin dhe potencialisht të ndërtojnë marrdhënie shitëse me blerës të ndryshëm.

Gjithashtu, IADK ka vazhduar të përmirësojë kapacitetet e stafit përmes vizitave në vendet europiane, më saktësisht gjatë vitit që kaloi, stafi IADK ka organizuar vizitë disa ditore në Greqi me qëllim që të njihet me praktikën bujqësore sa i përket adresimit të problemeve në raport me ndryshimet klimatike dhe në zbatimin e praktikave të mira për një bujqësi të qëndrueshme.



SHËRBIMET E OFRUARA NGA NE

Krahas implementimin të një numri të projekteve të financuar nga donatorë të ndryshëm, IADK ka pasur një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të ndryshme për akterë dhe donatorë të cilët kanë pasur për qëllim zhvillimin dhe fuqizimin e bujqësisë Kosovare.

- Projekti “Zhvillimi Ekonomik Rurali i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës (SIREN) i zbatuar nga Caritasi Zvicëran, ku IADK ka ofruar shërbime të larmishme në fushën e zhvillimit të sistemit të tregu i njohur si “Market System Development”, mbështetje teknike bujqësore, njëkohësisht trajnime dhe shërbime për zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale në fushën e bujqësisë organike. Krahas këtyre shërbimeve, IADK ka vazhduar të jetë një nga akterët kryesore në fushën e ofrimit të udhëzimeve për menaxhimin e projektit sipas kërkesave të tregut dhe fermerëve.
- Projekti “Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë”, projekt i mbështetur financiarisht nga DRC dhe zbatuar nga IADK e i cili ka për qëllim që fillimisht të hulumtoj tregun dhe sektorët të cilët janë me rëndësi për zhvillimin e bujqësisë në komunat e rajonit të Prishtinës dhe Mitrovicës. Në këtë kontekst, IADK vazhdon të ofroj ekspertizën e saj duke hulumtuar se cilët nga sektorët mund të jenë profitabil për komunitetin, e në veqanti për komunitetin jo shumicë, e po ashtu komunat të cilat mund të jenë përfituese të mbështetjes që do të vie nga projekti në vitet në vazhdim.
- Projekti “Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat” i financuar nga SDC dhe zbatuar nga Swisscontact, ku IADK është angazhuar në ofrimin e shërbimeve për identifikimin ndërmarjeve dhe njësive përpunuese dhe fuqizimin e tyre në digjitalizimin e shërbimeve dhe marketingut.



PARTNERITETET NDËRKOMBËTARE

IADK, ka ndërtuar një rrjet të fortë partneritetesh lokale dhe ndërkombëtare, duke integruar kontributin e tyre në misionin e saj për zhvillimin e bujqësisë, promovimin e diversitetit dhe përfshirjen shoqërore.

IADK ofron shërbime këshillimore profesionale në bashkëpunim të ngushtë me këta partnerë:


1. SENIOR EXPERTEN SERVICE (SES): Organizatë vullnetare e Gjermanisë, fokusuar në ngritjen e kapaciteteve në arsimimin dual të përpunimit të ushqimit.
2. Forumi Evropian për Shërbimet Këshillimore Bujqësore dhe Rurale (EUFRAS): Rrjet evropian për shërbime këshillimore publike, ku IADK është anëtare që nga viti 2016.
3. Rrjeti i Shërbimeve Këshillimore të Evropës Juglindore - SEASN: Rrjet i themeluar në Bullgari në vitin 2015, që përfshin shërbimet këshillimore bujqësore në shërbim të sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile.

Në nivel lokal, IADK është anëtare e Platformës CiviKos dhe Rrjetit të Grave të Kosovës, duke kontribuar ndaj pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e komunitetit në Kosovë.



TË ARDHURAT E IADK-SË NGA PROJEKTET/GRANTET


#	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Bread for the World - BftW Komunat (Drenasi, Podujeva, Mitrovica, Suhareka) Përfituesit e projektit	Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës	365,092	57%
			43,610	
			17,420	
2	Organizata Feministe e Paqes-CFD/FRIEDA Komunat (Vushtri, Shtime) Përfituesit e projektit	Fuqizimi i të rinjve dhe grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit	96,137	17%
			24,000	
			9,315	
3	GIZ	Promovimi ekonomik për të stabilizuar tregun e punës. Forcimi i zinxhirit të vlerës përmes programit të zhvillimit të aftësive	113,401	15%
4	USAID Compete IADK	Rritja e zhvillimit të aftësive në sektorin e përpunimit të ushqimit në Kosovë	49,812	8%
			13,670	
5	FAIRshare	Digjitalizimi i shërbimeve këshillimore në fushën e bujqësisë	11,948	2%
6	Këshilli Danez për Refugjatë -DRC	Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit të Bujqësisë	6,348	1%
7	Zyra e Bashkimit European në Kosovë	Mbështetja e punësimit të të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë	1,500	0.2%
Total			752,252	100%



Shënim: Të dhënat janë paraqitur mbi shpenzimet e bëra për vitin 2023, ndërsa të hyrat janë njohur në raport me shpenzimet e bëra referuar projekteve.

TË ARDHURAT E IADK-SË NGA PROJEKTET/SHËRBIMET

#	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	EPI Centar/SKAT	Mbështetje Teknike për Bujqësinë në Kosovë në kontekstin e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore	52,842	50%
2	Swisscontact Kosovo/PPSE	Nxjtja e punësimit në sektorin privat	6,162	6%
3	SOWI Kosovo	Dizajnimi dhe zbatimi i programit të rivendosjes së mirëqenjes	15,254	15%
4	Caritas Switzerland	Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik rural	8,375	8%
5	YES	Shfrytëzimi i zyrës me qira	3,325	3%
6	Komunat: Vushtrri, Shtime, Drenasi, Podujeva, Mitrovica dhe Suhareka	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	15,765	15%
7	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Projekti për punësim Superpuna	3,168	3%
Total			104,891	100%



MIRËNJOHJE PËR STAFIN

Një punë e suksesshme me rezultate të prekshme do të ishte e vështirë e arritshme pa një përkushtim e angazhim të stafit cilësor, prandaj IADK shpreh falënderimin dhe mirënjohjen për stafin e saj dhe praktikantët.


Bordi Drejtues



Shyqyri Hyseni
Kryesues i bordit



Myrvete Badivuku
Antare e bordit



Xhavit Merovci
Antar i bordit



Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Basri Pulaj
Kordinator i Programit
& Menaxher i Projektit



Egzon Gërshaliu
Menaxher i Projektit



Ardian Jashari
Menaxher i Financave



Hafize Veseli
Menaxhere e Projektit



Sylejman Bunjaku
Menaxher i Projektit



Esra Kurshumlja
Zyrtare e Projektit



Besnik Demiri
Menaxher i Projektit



Fjolla Gashi
Menaxhere e Projektit



Artiola Xhaka
Zyrtare e Projektit
për Barazi Gjinore



Elheme Shala
Asistente e Financave



Engjellushë Gjyshinca
Asistente e Prokurimit
dhe Administratës



Egzona Hajra
Zyrtare e projektit dhe
Inxhinier e Bujqësisë



Adisa Osmani
Zyrtare e Prokurimit
dhe Administratës



Jehona Drevinja
Zyrtare e Prokurimit
dhe Administratës



Leonora Hajra
Inxhinier e Blegtorisë



Hasan Cena
Inxhinier i Teknologjisë
Ushqimore



Hanumshahe Zeneli
Asistente e Projektit



Gëzim Murseli
Inxhinier i Bujqësisë



Halit Gashi
Inxhinier i Bujqësisë



Ferki Surdulli
Mirëmbajtës i objektit



Ilmihate Surdulli
Mirëmbajtëse
e objektit



Albesa Beqiri
Inxhinier e
Teknologjisë Ushqimore



Novica Markovic
Inxhinier i Bujqësisë



Petrit Koci
IT



Xhentina Zeka
Praktikante e projektit



Fjolla Kahrmani
Praktikante e projektit



Gafurr Uka
Praktikant i projektit



Blend Preniqi
Praktikant i projektit



Donjeta Fazliu
Praktikante e projektit



Valmira Aliu
Praktikante e projektit



Adresa:
Sfaraçak i Ulët, St. Miran Xhafa,
no.11, 42,000 Vushtrri, Kosovo



Website:
www.iadk.org



Mediat Sociale:
facebook.com/iadk.org



<https://www.linkedin.com/company/iadkorg>



<https://www.youtube.com/@iadk8611>



Kontakti:
+383 49 777 046

+383 44 777 036



info@iadk.org